

Të nderuar miq,

Kemi kënaqësinë e veçantë që sot të lansojmë Institutin e Kosovës për Politikën Evropiane, apo European Policy Institute of Kosovo (EPIK). Po, e saktë - është EPIK .

Instituti EPIK është think-tank i pavarur dhe jo-fitimprurës që bashkon një ekip të veçantë profesionistësh, me një objektiv të vetëm për të mbështetur përpjekjet e integritit evropian të Kosovës.

Së bashku, në sjellim 20 vite përvojë në procesin e integritit Evropian. Puna jonë bazohet në ekip të talentuar dhe përkushtuar, nga i tërë Ballkani Perëndimor dhe BE, që angazhohet për krijimin e politikave alternative publike, hulumtimeve, analizave dhe debateve të hapura.

Por në esencë, EPIK-u është një storie e pathënë e miqve, të cilët i bashkoi besimi i tyre për një Kosovë më të mirë Evropiane.

Në këtë letër të lansimit të punës së EPIK-ut, dëshirojmë të shpjegojm përse krijuam EPIK-un.

Procesi i integritit është prioritet strategjik i Kosovës. Dhe, në fakt, është një proces epik.

Kosova ka arritur shumë që nga shpallja e pavarësisë në 2008. Prej pothuaj asnjë marrëdhënie me BE-në, sot Kosova është pjesë e procesit zyrtar integruar në BE, dhe palë e barabartë e pothuaj çdo mekanizmi rajonal dhe Evropian.

Marrëveshja Stabilizim Asociimi ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. MSA-ja përbënë bazën tonë ligjore për anëtarësim në BE. Në vitin 2016, Kosova dhe BE-ja kanë lansuar Agjendën Evropiane të Reformave – një numër të reformave afat-shkurtëra në sundimin e ligjit, konkurrueshmërisë dhe arsimit. Liberalizimi i vizave është lansuar në vitin 2012 dhe në vitin 2018 jemi në pritje të vendimit përfundimtar të Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian. Kosova është përfitues më i madh i fondeve të BE-së në botë, për kokë banori.

Sidoqoftë, institucionet e Kosovës janë ende të brishta dhe skena politike është e pa pjekur politikisht. Sundimi i ligjit është fragjil, qeverisja e dobët, ndërsa ekonomia vuan nga mungesa e bazës së fuqishme dhe tëlë qëndrueshme ekonomike.

Rezultatet e Kosovës në zbatimin e MSA-së mbesin shumë të dobëta. Migrimi, krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të sfidojnë procesin e liberalizimit të vizave. Ka mungesë serioze të konsensusit dhe vullnetit politik për të zbatuar reformat Evropiane, siç janë: reforma zgjedhore, lufta kundër korrupsionit, pavarësia e sistemit prokurorial dhe gjyqësor, dhe depolitizimi i institucioneve publike.

Njëkohësisht, përveç pengesave të brendshme, Kosova vazhdon të ballafaqohet me një mjedis sfidues edhe në aspektin e jashtëm: Serbia vazhdon të minojë angazhimet e Kosovës në arenën ndërkombëtare, 5 vende mos-njohëse të BE-së nuk janë duke lëvizur nga qëndrimet e tyre karshi Kosovës, ndërsa në BE vërehet ngritja e fuqisë politike të partive të djathëta dhe nacionalizmit në përgjithësi. Dialogu me Serbinë vazhdon të sfidojë skenën politike të Kosovës.

Në këtë drejtim, Kosova duhet të konsolidoj të gjitha resurset e disponueshme për të mbështetur procesin e integritimit Evropian.

Ne kemi krijuar institutin EPIK si një kontribut modest për procesin e integritimit Evropian. Ne do të zbatojmë politikën publike në bashkëpunim me institucionet dhe partnerët ndërkombëtar, por do të mbajmë pushtetin përgjegjës për veprimet e tij – gjithnjë duke besuar në një Kosovë më të mirë Evropiane.

Në fund fare, EPIK-u në fakt ka një objektiv të vetëm përfundimtar – të sfidojë paradigmat e një shoqërie gjithnjë më Evropiane të Kosovës. Ironia është që ky objektiv apo destinacion asnjëherë nuk mund arrihet. Kufijtë e njohurive tona do të levizin çdo herë e më shumë si shoqëri. Në fakt, është rrugëtimi aj që e bënë të vëçantë. E bënë epik.

Sinqerisht,



Taulant Kryeziu
Kryesues i Bordit Ekzekutiv



Demush Shasha
Drejtore Ekzekutiv